

UDHËZIM
Nr. 24, datë 1.8.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 28.1.2020, “PËR
PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË DREJTORIT
TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, shkronja “a”, e pikës 1, të seksionit B, të kreut I, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi